



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:056858

Datë: 19.03.2024

Numri i dokumentit: 05473724

PP.nr.652/19

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Ibrahim Maloku, si dhe me bashkëpunëtorin profesional Festim Zeqiri në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit N.P. “Termokos”, sh.a., me seli në Prishtinë, rr.28 Nëntori, kundër debitorit I. G nga Prishtina, Lagja, H:-, Nr., Prishtinë, lidhur me çështjen përmbartimore pagesë e borxhit, vlera 739.77€, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori, kundër Urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr.252/2019, të datës 25.03.2019, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Ilir Mulhaxha nga Prishtina, jashtë seancës gjyqësore, me datë 19.03.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht i bazuar prapësimi i debitorit I. G nga Prishtina, Lagja, H:-, Nr., ashtu që SHFUQIZOHET pjesërisht urdhëri përmbartimor P.nr.252/2019, i datës 25.03.2019 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Ilir Mulhaxha në Prishtinë dhe atë për periudhën nga data 01.10.2016 deri me datë 31.12.2017, në shumë prej 423.21€.
- II. REFUZOHET prapësimi i debitorit I. G, ashtu që Urdhëri Përmbartimor P.nr.252/2019 i datës 25.03.2019 i Përmbartuesit Privat Ilir Mulhaxha në Prishtinë, MBETET në fuqi për periudhën 01.01.2018 deri me datë 31.12.2018, për shumën e borxhit 316.56€, deri në përmbushjen përfundimtare të detyrimit.
- III. Në rast se debitori parashtron ankesë kundër këtij aktvendimi, OBLIGOHET që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e ushtrimit të ankesës, ta paguaj garancionin në xhirollogarinë e kësaj gjykate në shumën prej 316.56€ (Euro).
- IV. Në rast se debitori dështon të paguaj shumën e lartcekur të garancionit brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare.

A r s y e t i m

Përmbaruesi privat Ilir Mulhaxha, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhëri me të cilin ka lejuar përmbarimit në bazë të kartelës së kontabilitetit në emër të debitorit I.G për periudhën 01.10.2016 deri me datë 31.12.2018, me të cilin ka kërkuar që debitorit të obligohet të ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 739.77€, të gjitha detyrimet të përmbushen përmes bllokimit të llogarisë bankare apo regjistrimi dhe sekuestrimi i sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe përmes shitjes së tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Kundër urdhërit për lejimin e përmbarimit brenda afatit ligjor debitori ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar në tërsi propozimin për përmbarim të kreditorit duke theksuar se nuk i ka borxh kreditorit sepse gjatë periudhës për të cilën kërkohet borxhi, në pjesën dërmuese të kohës fare nuk ka pas nxemje dhe përveç kësaj e ka informuar kreditorin se nuk banon në këtë adresë. Tutje ka shtuar se borxhi të cilin e kërkon kreditori është i parashkruar në bazë të nenit 360 paragrafi 1.1 i Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore. Mbi bazën e të lartcekurave i ka propozuar gjykatës që të hedhet poshtë propozimi për përmbarim.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim ku ka theksuar se është i padrejtë prapësimi i debitorit I. G se nuk ka pas ngrohje sepse nuk ka asnjë provë të bashkangjitur se nuk ka pas ngrohje e as ndonjë ankesë me shkrim dhe nëse debitori nuk ka qenë i interesuar që të pranoj shërbimet e kreditorit atëherë është dashtë të ushtroj kërkesë për shkyçje e jo të pres grumbullimin e borxhit dhe në fund të mundohet përmes prapësimit të prolongoj procedurën përmbarimore si dhe të thirret në parashkrim të kërkesës duke u mundur që ti ik pagesave. Lidhur me parashkrimin kreditori ka shtuar se gjykata nuk duhet të anashkaloj nenin 360 par. 2 i LMD-së e cila i jep të drejtë kreditorit që ti kërkoj borxhet deri në muajin Dhjetor 2019 e që nënkupton tërë vitin 2018. Mbi bazën e të lartcekurave i ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi dhe të mbetet në fuqi urdhëri për përmbarim.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas studimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi është pjesërisht i bazuar, nga këto arsye:

Gjykata ka vlerësuar dokumentin e besueshëm – ekstraktin e verifikuar nga librat afarist 010209, dt.20.03.2019 në emër të I.G, për periudhën 01.10.2016 deri 31.12.2018, në bazë të së cilës organi përmbarues ka zbatuar përmbarimin dhe ka vlerësuar se i njëjti paraqet dokumente të besueshëm dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 29 par.1 pika 1.2 dhe par.3 e lidhur me nenin 40 par.1 pika 1.3 të LPP-së për të qenë i përmbarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarim.

Gjykata ka vlerësuar me kujdes pretendimet e debitorit lidhur me parashkrimin e kërkesës së kreditorit, dhe pas analizimit të këtyre pretendimeve në raport me provat të cilat ndodhën në shkresat e lëndës, gjykata ka ardhur në përfundim se në këtë çështje kemi të bëjmë me parashkrim të pjesshëm të kërkesës së kreditorit.

Kjo për faktin se me dispozitën e nenit 360 paragraf 1, pika 1.1 të LMD-së, (Ligji nr. 04/L-077), përcaktohet se: *“Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: Kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”*, ndërsa me paragrafin 2 të po këtij neni, përcaktohet se: *“ Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë”*.

Kurse me nenin 368 paragraf 1 të LMD-së, (Ligji nr. 04/L-077) përcaktohet se: “*Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin*”, ndërsa me paragrafin 2 të po këtij neni, përcaktohet se: “*Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthorë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit*”. Po ashtu edhe me nenin 369 të LMD-së, të këtij ligji përcaktohet se: “*Parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarr kundër debitorit para gjykatës ose autoritetit tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës*”.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave rezulton se, kërkesat për furnizim me energji termike parashkruhen brenda afatit prej një viti, ndërsa afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga fundi i vitit në të cilin kërkesa arrin për pagesë. Gjykata ka vlerësuar me kujdes pretendimet e debitorit lidhur me afatet e parashkrimit dhe ka ardhur në përfundim, se në këtë çështje kemi të bëjmë me parashkrim të pjesëshëm të kërkesës së kreditorit në pajtim me dispozitat e nenit 360 par.1 pika 1.1 lidhur me par. 2 të LMD-së. Kreditori ka kërkuar përmbarrimin e borxhit për periudhën nga data 01.10.2016 deri me datë 31.12.2018, ndërsa propozimin për përmbarrim e ka paraqitur me datë 22.03.2019. Bazuar në këtë, rezulton se borxhi i kreditorit është pjesërisht i parashkuar, dhe atë për periudhën 01.10.2016 deri me datë 31.12.2017 kjo për faktin se nga dita kur janë bërë të arritshme kërkesat periodike për këtë periudhë, e deri në ditën kur është paraqitur propozimi për përmbarrim, për të gjitha kërkesat prej datës 31.10.2016 deri me datë 31.12.2017 ka kaluar më shumë se një vit, andaj gjykata konstaton se në rastin konkret lidhur me periudhën kohore të cekur si më lartë kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës, kjo për faktin se ka kaluar koha e paraparë me ligj brenda të cilit kreditori mund të kërkojë përmbarrimin e detyrueshëm të kërkesës së tij karshi debitorit.

Deri tek shuma prej 316.56€ për të cilën propozimi për përmbarrim është lënë në fuqi, gjykata erdhi nga llogaritja e faturimeve për periudhën 31.01.2018 deri me 31.12.2018 periudhë kjo për të cilën nuk ka parashkrim të kërkesës dhe rezulton se për të njëjtën debitori i ka borxh kreditorit shumën prej 316.56€. Ndërsa prej datës 01.10.2016 deri me 31.12.2017 për të cilën ka parashkrim të kërkesës rezulton shuma prej 423.21€ për të cilën urdhëri përmbarrimor P.nr.252/19 i dt.25.03.2018 duhet të shfuqizohet.

Në momentin e vendosjes, gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e debitorit lidhur me atë se në periudhën për të cilën kërkohet borxhi nuk ka pas furnizim me ngrohje dhe se debitori nuk banon në atë adresë, mirëpo gjykata këto pretendime i vlerëson të pabazuara për faktin se procedura përmbarrimore është procedurë e karakterit rigoroze-formale në të cilën bëhet realizimi i drejtpërdrejte i të drejtave të njohura në bazë të titullit ekzekutiv në këtë rast dokumentit të besueshëm - ekstraktit nga librat e kontabilitetit. Për më tepër debitori nuk ka paraqitur asnjë provë materiale se ndonjëherë ka iniciuar ndonjë procedurë pranë kreditorit se e njëjta e ka faturuar edhe pse nuk ka pas furnizim me ngrohje apo ka faturuar në mënyrë paushalle sepse debitori nuk ka banuar në këtë adresë.

Gjykata vlerëson se pjesërisht janë plotësuar kushtet ligjore për paraqitje të prapësimit në bazë të nenit 71 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit të Procedurës Përmbarrimore ku si shkak për paraqitje të prapësimit parashihet: “*Sipas nenit 69 të këtij ligji, prapësimi mund të bazohen vetëm nëse: . ka skaduar afati kohor brenda të cilit, sipas ligjit, mund të kërkohet përmbarrimi*”, e që në rastin konkret të çështjes juridike në fjalë është vërtetuar se kemi të bëjmë me parashkrim të pjesëshëm të kërkesës së kreditorit.

Mbi bazën e të lartcekurave, gjykata gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar, andaj të njëjtin vendosi që ta aprovoj pjesërisht në bazë të nenit 73 paragrafi 3 i Ligjit të

Procedurës Përmbartimore dhe vendosi si në pikën I, kurse pjesën tjetër të prapësimin e refuzoj si të pabazuar sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata e obligoi debitorin që në rast të parashtrimin të ankesës kundër këtij aktvendimi, në afat prej 7 ditësh ta paguajë garancionin në mjetet buxhetore të gjykatës në shumën prej 316.56€, duke u mbështetur në dispozitën nga neni 78 par.2 të LPP-së, ndërsa në pikën IV të dispozitivit e paralajmëroi debitorin se në rast të dështimit të pagesës së shumës së përcaktuar nga Gjykata brenda afatit të paraparë, ankesa do të konsiderohet se nuk është paraqitur fare, në kuptim të nenit 78 par.4 të LPP-së.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
-Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil -
PPP.nr.652/2019, dt.19.03.2024

Gjyqtari,
Ibrahim Maloku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.